



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-09-0059

Paditësi

Gj Gj Gjakovë.

Kundër

E paditura

SH. K “ E”, Gjakovë, përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Hajrie Shala dhe Asllan Krasniqi gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 06 shtator 2022, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Padi e paditësit Gj Gj Gjakovë, e paraqitur kundër të paditurës SH. K “ E”, Gjakovë, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe kthimin në posedim të paluajtshmërisë, konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 23 prill 2009, paditësi ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS), një padi për vërtetimin e pronësisë, dhe kthimin në posedim të paluajtshmërive, kundër të paditurës SH. “E” në Gjakovë.

Në padi, paditësi ka theksuar se është pronar i sipërfaqes prej 6 ha, e cila tani është pjesë e kompleksit të evidentuar si parcelat me nr.375 dhe nr.380 KK D dhe se e njëjta është marrë nga e paditura pa asnjë bazë juridike apo kompensimi. Tutje paditësi ka pohuar se lidhje me këtë çështje ka ngritur padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë para luftës. Bashkangjitur me padinë, paditësi ka dorëzuar në gjykatë edhe njoftimin për AKP-në, për paraqitjen e padisë kundër SH.A K. “E” në Gjakovë. I ka propozuar gjykatës që të vërtetoj se i njëjti është pronar i ngastrave nr. 375 dhe nr.380 KK D dhe e paditura të ia kthej paditësit paluajtshmerin në posedim.

Me 23 prill 2009, gjykata ka lëshuar vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore.

Me 7 maj 2009, paditësi ka paraqitur kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.

Me datë 15 maj 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS, mori Aktvendim, që padia e paditësit të pezullohet, deri atëherë kur DHPGJS, të marrë vendim për lëndën me nr. SCC-08-0124, lidhur me statutin e të paditurës në fjalë, me arsyetimin çështja e statusit ligjor të NSH-së , është çështje paraprake ndaj padisë për të drejtën pronësore.

Me 21 mars 2022, gjykata ka hequr pezullimin e vendosur më 15 maj 2009.

Me 23 mars 2022, gjykata me Aktvendim ka refuzuar kërkesën e paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore dhe ka kërkuara nga ai që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit. Paditësi është njoftuar se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, padia do të konsiderohet e tërhequr. Me 28 mars 2022, paditësi ka pranuar aktvendimin në fjalë, por ai nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.4 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Paditësi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Në vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 7 maj 2009, paditësi ka paraqitur kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.

Me 23 mars 2022, gjykata me Aktvendim ka refuzuar kërkesën e paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore dhe ka kërkuara nga ai që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit. Paditësi është njoftuar se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi ka pranuar aktvendimin në fjalë me 28 mars 2022, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi.

Paditësit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bej pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Paditësi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Hajrie Shala, gjyqtare

Asllan Krasniqi, gjyqtar